


01-9416



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.391/02-182872/23 dt.05.09.2023, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Bislim Cërvadiku dhe Hashim Cërvadiku nga Prishtina dhe investitorit “Exclusive Desing Company” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Rexhep Krasniqi”, Hyrja A kati 1 nr. 1, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A1”, të Planit Rregullues “Kalabria”, në rr. “Fadil Hoxha”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 28.05.2024, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuësve / bashkëpronarëve, Bislim Cërvadiku dhe Hashim Cërvadiku nga Prishtina dhe investitorit “Exclusive Desing Company” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810797780, sipas kërkesës 05Nr.391/02-182872/23 dt.05.09.2023, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+P+8, e ndërtuar sipas “Aktvendimit”, 05Nr.351-197942 dt.20.12.2013, dhe “Konkluzionit”, 05Nr.350-251588/1 dt.11.01.2016, në parcelën kadastrale nr. 7580-6, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A1”, të Planit Rregullues “Kalabria”, në Prishtinë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Fadil Hoxha” ku ka dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 93, 95, 97, dhe 99, në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkuësit / bashkëpronarët, Bislim Cërvadiku dhe Hashim Cërvadiku nga Prishtina dhe investitorit “Exclusive Desing Company” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me kërkesën me 05Nr.391/02-182872/23 dt.05.09.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+P+8, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A1”, të Planit Rregullues “Kalabria”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 7580-6 ZK Prishtinë, ndërtuar sipas “Aktvendimit”, 05Nr.351-197942 dt.20.12.2013, dhe “Konkluzionit”, 05Nr.350-251588/1 dt.11.01.2016, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-126283/23 dt. 04.03.2023, ka përcjellë

Faqe 1 prej 2

në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 6 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Procesverbalet e kontrollit inspektues për të gjitha fazat; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Naser Canolli/Valbona Saliuka; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Ibrahim Hoxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Violeta Hoxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Valbona Osmani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Shukrije Krasniqi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Zekrija Elezi me nr. të licensës 17;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm si dhe ndërtesa garazhuese mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesa shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZIMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**  
**05 NR. 391/02-182872/23 DT. 28.05.2024**

Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi



Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  
B. VLLASALIU